**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 732/2 Prot                                                                 Rrëshen më, 26 . 03 . 2025

**V E N D I M**

**Nr. 25 datë 25. 03. 2025**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**
**BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", *relacionin nr. 732 prot, datë 17.02.2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Ndue Nikoll Prenga", nga Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Ekonomike,* së bashku me projektin e Kryetarit bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Z. Ndue Nikoll Prenga me ID; I90227047M, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, kushte të vështira jetese e mugesë të ardhurash finaciare, me trenjakë me nga 5 000 lekë në muaji/për fëmijë, për një periudhë 1 vjeçare, viti 2025

   a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;......**15 000** lekë/muaji

   b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.......**15 000** lekë/muaji

2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Ky vendim i shtrinë efektet financiare për vitin kalendarik 2025

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

| **S E K R E T A R** | **K R Y E T A R** |
|---|---|
| **Gaspër TOPOLLAJ** | **Aleksandër PICAKU** |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOCI" RRËSHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al    tel dhe fax : (00355) (0) 2162233    www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

**P/V E N D I M**

**Nr** 732 / 1 **Prot** — **Datë** 17 / 03 /2025

**Nr.** 28 **date.** 17. 03 **.2025**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", ,ne VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", në relacionin, nr.732 prot, datë.17.02.2025, "Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Ndue Nikoll Prenga", e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi si me poshte;***

1.Të japë ndihmë financiare familjes së z.Ndue Nikoll Prenga Njesia Administrative Rreshen, per kushte te veshtira jetese me trenjake, me nga 5000(pesemije)leke ne muaji/per femije, per nje periudhe nje vjeçare, viti 2025.

**a-Paksim** fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA...604) për shumën ***15 000 lekë /muaji***

***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA......606) për shumën ***15 000 lekë/muaji***

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

3.Ky p/vendim i shtrin efektet financiare për periudhën në vazhdim në buxhetin e vitit 2025.

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e finances dhe buxhetit***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes***

**SEKRETARI** — **KRYETARI**

**Gaspër TOPOLLAJ** — **Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ekon dhe tatim taksave :Vjollca Gjoka

Dr.Juridike:Manjola Doda

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

Financa

**BASHKIA MIRDITË**

**AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE**

Nr.732 Prot. Rrëshen, më 17.02.2025

**Lënda:** Relacion

**Drejtuar:** Drejtorisë së Financës së Bashkisë Mirditë

Në këtë relacion do të paraqesim informacion mbi familjen Ndue Nikoll Prenga, e cila ka 5 fëmijë, tre prej të cilëve janë trenjakë, që është pjesë e skemës së NE dhe që është mbështetur financiarisht edhe herë të tjera në të kaluarën.

**1. Përshkrimi i familjes:** Familja përbëhet nga 7 anëtarë: kryefamiljari z.Ndue Nikoll Prenga, i lindur në Bukmirë më 27.02.1989, me NID 190227047M, bashkëshortja zj.Kristina Ndrec Prenga, e lindur në Arrez më 08.04.1990 me NID J05408038S dhe 5 fëmijët, dy vajza të moshës 12 dhe 8 vjeçe dhe trenjakët 1 vjeç e gjysmë. Ata jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe kanë shumë vështirësi për të përmbushur nevojat e përditshme. Banesa në të cilën jetojnë është 1+1, hapësirë e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e familjes. Problematikë tjetër është situata shëndetësore e njërit prej trenjakëve, i cili ka një problem fizik, për trajtimin e të cilit nevojiten 10.000 lekë të reja çdo muaj.

**2. Situata financiare e familjes:** Familja është në gjendje të vështirë ekonomike dhe përfiton ndihmë nga Bashkia përmes programit të NE. Shuma që kjo familje përfiton nga NE është 18 500 lekë, të ardhura të tjera vijnë nga puna e kryefamiljarit, i cili mundohet të gjejë punë vazhdimisht për ta zbutur situatën e vështirë financiare të familjes. Gjithsesi, të ardhurat mujore që familja përfiton janë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e shumta që kjo familje ka.

**3. Historiku i ndihmës nga Bashkia:** Kjo familje ka marrë ndihmë nga Bashkia edhe në të kaluarën. Pjesë e kësaj ndihme ka qenë shpërndarja e pakove me ushqime, si dhe mbështetje

financiare e dhënë nga Bashkia. Bashkia ka monitoruar situatën e tyre nëpërmjet Shërbimit Social dhe është munduar të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për këtë familje.

**4. Nevojat e familjes:** Megjithëse familja ka përfituar ndihmë ekonomike, nevojat e saj mbeten të mëdha. Fëmijët kërkojnë mbështetje për arsimimin dhe shëndetin e tyre, dhe për këtë arsye, është e nevojshme që Bashkia të vazhdojë të ofrojë mbështetje të shtuar për këtë familje. Gjithashtu, ndihma që ka të bëjë me kushte më të mira jetese është një aspekt i rëndësishëm që kërkon vëmendje.

**5. Përfundim:** Duke marrë parasysh situatën e vështirë ekonomike dhe numrin e fëmijëve të vegjël, është e domosdoshme që Bashkia të vazhdojë mbështetjen për këtë familje, duke siguruar që ata të kenë mundësi për një jetë më të mirë dhe më të sigurt. Për këtë arsye, si Shërbim Social e vlerësojmë tëë domosdoshëm dhënien e një mbështetje finaciare për këtë familje.

Konceptoi: Adela Gjikola

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni



email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al